



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**  
**V E N D I M**  
**K.P.P.604/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Gjeokonsult & CO” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr. REF-15427-05-29-2017, me objekt “Mbikqyrje punimesh për objektin “Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh, Mallakastër”, me fond limit 1.326.999 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 09.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.

**Ankimues :** “Gjeokonsult &CO“ shpk  
Adresa: Kashar, Kthesa e Kamzës, Pallati Mëhillaj Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mallakastër  
Lagjia “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

**Vëren:**

## Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Ligji i Prokurimit Publik, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Nuk ka respektuar formën dhe mënyrën e paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

## II

### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr. REF-15427-05-29-2017, me objekt “Mbikqyrje punimesh për objektin “Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh, Mallakastër”, me fond limit 1.326.999 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 09.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.

II.2. Në datën 09.06.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën 1271/1 Regj. datë 11.07.2017 protokolluar me tonën me nr. 1203/2prot., datë 13.07.2017 me objekt: “Informacion mbi procedurën e prokurimit[...]”, rezulton se në datën 19.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Florian Abedinaj	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike			
Novatech Studio	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike			
Gjeokonsult &Co		980.000	lekë	skualifikuar
Dricons		1.181.029	lekë	skualifikuar
Tower		1.195.500	lekë	skualifikuar
Invictus		1.326.000	lekë	tërhequr nga oferta
BOE “Arena MK” & “Natasha Myrtaj		1.326.999	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.06.2017 operatori ekonomik “Gjeokonsult &CO“ shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*Nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit. Konkretisht, nuk plotëson pikën 8, të pikës 2.3. “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 6 të DT, pasi Oferta e tij nuk është ndërmjet vlerës minimale dhe asaj maksimale (është më e ulët se vlera minimale e lejuar, e cila është 1.259.630 lekë pa TVSH) sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “çmimi më i ulët”*

II.5. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën nr. 1271/1 Regj., datë 11.07.2017 (protokolluar me tonën me nr. 1203/2prot., datë 13.07.2017), në datën 24.06.2017 operatori ekonomik “Gjeokonsult &CO“ shpk., ka paraqitur ankesë në mënyrë elektronike pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimuesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

[...]

*Kjo arsye skualifikimi na duket jo e drejtë. VKM-ja nr. 354 datë 11.05.2016 “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim mbikëqyrje dhe kaudim”, përdoret nga ana e projektuesit apo autoriteti kontraktor, përkatësisht për llogaritjen e fondit të përgjithshëm të projektit apo fondit limit që do të vendosë ai në tender.*

*Në këtë mardhënie që kemi krijuar ne po garojmë si operatorë ekonomikë ku na jepet një fond limit përkatësisht 1.326.999 lekë pa TVSH, për të cilin ndër kërkesa të tjera na kërkohet dhe oferta jonë ekonomike. Në cilësinë e oe-së, aq më tepër kur na është dhënë fondi limit, ne nuk kemi asnjë detyrim për të llogaritur sëruisht atë. Detyra jonë e vetme është të paraqesim një ofertë e cila të mos jetë anomalisht e ulët dhe e justifikuar mirë. Në dt është kërkuar që oferta të jetë e detajuar dhe të tillë e kemi paraqitur. Kërkesat tuaja të mëtejshme na duken jo të përshtatshme dhe me tendencë për të na skualifikuar nga gara. Për më tepër ne nuk kemi mundësinë reale për ta llogaritur atë, pasi nuk na është dhënë kosto totale e veprës.*

*Theksojmë se nuk mund të skulifikohemi nga tenderi për arsye të tillë, pasi kjo do të ishte një ndryshim i praktikës, që ndodh pa asnjë instruktim apo orientim të mëparshëm nga ana juaj dhe që e dëmton rëndë konkurrencën në garë. Nëse një ose disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta, kvo duhet të kërojnë sqarime nga ofertuesi, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Ju si ak nuk keni zhvilluar këtë fazë duke lënë të paqartë për gjykimin tuaj. Në bazë të nenit 21 “e drejta për informim” të LPP-së, ne kërkojmë informacionin për mënyrën se si keni kërkuar të llogarisim ofertën.*

II.6. Në datën 27.06.2017, me shkresën nr. 1186 prot, operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult &CO“ shpk është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 03.07.2017 operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult &CO“ shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij.

II.8. NËPËRMJET shkresës nr.1271/1Regj, datë 11.07.2017 protokolluar me tonën me numër 1203/2prot., datë 13.07.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresësn 1271/1 Regj., datë 11.07.2017 protokolluar me tonën me nr. 1203/2 prot., datë 13.07.2017 me objekt “*Informacion mbi procedurën e prokurimit[...]*”, rezulton se në datën 03.07.2017 autoriteti kontraktor ka lidhur kontratën.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Në datën 30.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr.REF-15427-05-29-2017, me objekt “*Mbikqyrje punimesh për objektin “Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh, Mallakastër*”, me fond limit 1.326.999 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 09.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.

III.1.2. Në datën 09.06.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.1.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresësn 1271/1 Regj. datë 11.07.2017 protokolluar me tonën me nr. 1203/2 datë 13.07.2017 me objekt “*Informacion mbi procedurën e prokurimit[...]*”, rezulton se në datën 19.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Florian Abedinaj	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike			
Novatech Studio	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike			
Gjeokonsult &Co	980.000	lekë	skualifikuar	
Dricons	1.181.029	lekë	skualifikuar	
Tower	1.195.500	lekë	skualifikuar	
Invictus	1.326.000	lekë	tërhequr nga oferta	
BOE “Arena MK” & “Natasha Myrtaj	1.326.999	lekë	kualifikuar	

III.1.4. Në datën 19.06.2017 operatori ekonomik “Gjeokonsult &CO“ shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*Nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit. Konkretisht, nuk plotëson pikën 8, të pikës 2.3. “Kapaciteti teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 6 të DT, pasi Oferta e tij nuk është ndërmjet vlerës minimale dhe asaj maksimale (është më e ulët se vlera minimale e lejuar, e cila është 1.259.630 lekë pa TVSH) sipas*

*përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “çmimi më i ulët”*

III.1.5. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën nr. 1271/1 Regj., datë 11.07.2017 (protokolluar me tonën me nr. 1203/2prot., datë 13.07.2017), në datën 24.06.2017 operatori ekonomik “Gjeokonsult &CO“shpk., ka paraqitur ankesë në mënyrë elektronike pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor.

[...]

III.1.6. Në datën 27.06.2017, me shkresën nr. 1186 prot, operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult &CO“ shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.7. Në datën 03.07.2017 operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult &CO“ shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar përkatësisht:

[...]

*“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.*

*“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”.*

*“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.*

*“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.1.9. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, “Ankesa në autoritetin kontraktor” citohet: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.

2. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP. Në rastin e procedurave me mjete elektronike, procesi i pezullimit bëhet sipas udhëzimeve të APP-së. 3. Ankimuesi përdor formularin



standard të ankesës, që përmban emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëljes së pretenduar. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet. Nëse mungon ndonjëri nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet nga zyrtari përkatës. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve pas njoftimit, ajo vlerësohet si e paparaqitur. Formulari i ankesës është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, të cilat janë të publikuara në faqen e internetit të APP-së.[...]

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë procedurë prokurimi, si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se ankesa e tij është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 24.06.2017, në mënyrë elektronike fakt ky i pohuar dhe vërtetuar me shkresën nr. 1271/1Regj. datë 11.07.2017, të autoritetit kontraktor.

III.1.11. Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, *strictu sensu* parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, ankimi i operatorit ekonomik “Gjeokonsult &CO“ shpk, drejtuar autoritetit kontraktor, nuk është bërë në formën sipas (me shkrim) formularit standard të ankesës, pjesë e dokumentave të tenderit, fakt ky i pranuar edhe nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, KPP gjykon se, megjithëse ankimi administrativ i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në mënyrë elektronike është shqyrtuar nga ky i fundit, konstatohet se ankimi nuk është dorëzuar në formën dhe mënyrën e parashikuar nga *lex specialis*, duke mos e legjitimuar *ratione temporis* operatorin ekonomik ankimues në dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor.

III.1.12. Nga verifikimet e kryera, rezulton se ankesa e operatorit ekonomik nuk është pranuar nga autoriteti kontraktor konform parashikimeve ligjore të ankimit parashikuar nga neni 63 pika 2 e LPP-së. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në kundërshtim me formën dhe mënyrën që parashikojnë dispozitat ligjore të LPP-së., c’ka përbën shkak të mospërbushjes të kushteve formale, pasi operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor në formë elektronike në datën 24.06.2017 në kundërshtim me nenin 63 pika 2 e LPP-së, që përcakton shprehimisht se ankimi duhet bërë me shkrim.

Komisioni vëren se, ankimi nuk është nisur përmes një rruge të pranuar nga pikpamja procedurale (Kodi i Procedurave Administrative), pra me shkrim. Operatori ekonomik, ka ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike ankesën dhe jo me shkrim siç edhe është parashikuar nga ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), ky i fundit është treguar neglizhent dhe i papërgjegjshëm për fatin e ankimit të tij, pasi ishte apo duhej të ishte e qartë për të se ankesa pranë autoritetin kontraktor *stricu lege* referuar nenit 63 pika 2 duhet të kryhet në formë shkresore.

III.1.13. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i ezaurimit të shkallëve të ankimit, është i një rëndësie thelbësore

e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.14. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk janë ndjekur shkallët e ankimit në respekt të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 ku parashikohet se: “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëlqjen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2) Respektimi i këtyre elementëve të sipërcituar janë të domosdoshmëm për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme” (pika 7).

III.1.15. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkalleve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gjeokonsult &CO“ shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr. REF-15427-05-29-2017, me objekt “Mbikqyrje punimesh për objektin “Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh, Mallakastër”, me fond limit 1.326.999 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 09.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1203 Protokoli, Datë 03.07.2017**

#### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar  
**Leonard Gremshi**

Anëtar  
**Hektor Balluku**

Anëtar  
**Odise Moçka**

Kryetar  
**Evis Shurdha**